

## **Komunikatë për Shtyp për Teatrin Kombëtar - Confindustria Albania**

Me një ndërhyrje të pakthyeshme u është rrëmbyer qytetit dhe banorëve të tij, një nga monumentet më të rëndësishme të kulturës shqiptare dhe europiane. Teatri Kombëtar u shemb në emër të përparimit që fsheh, jo aq mirë, vetëm prapambetjen kulturore dhe përçmimin për rrënjët e një populli të tërë.

Ashtu si çdo krim, aktiviteti i rrënimit u zhvillua në orën 4.30 të mëngjesit, kur ishte akoma errët, siç bëhet me diçka që duhet të fshihet. Dhe, në fakt, ka shumë pak për t'u krenuar kur i ke shkullur qytetit një vend të kulturës, një pjesë të historisë së tij dhe trashëgimisë jo shumë të madhe arkitekturore.

Me goditjet e buldozerëve, ne të gjithë u privuam nga një pjesë që ishte dëshmi e së kaluarës. Në të gdhirë u fshinë jetët e shumëfishta që lindën në atë vend; jo vetëm aktorët që performuan ose që punuan për të, por qindra njerëz që e panë të funksiononte. Në pak orë u fshi mundësia që qytetarët e nesërm të shijojnë një pjesë të kujtesës kombëtare.

Ishte një veprim frikacak, mjeran, i ulët. Një gjest që tregon gjithë papërgjegjshmërinë e klasës politike që drejton vendin, e cila filloi punën për të fshirë identitetin kombëtar, duke rezervuar të njëjtin fat edhe kopshtit të ulur (rezultat i punës së arkitektit gjenial Giulio Bertè, i ndërtuar në 1935 dhe rrënuar në vitin 2011) dhe stadiumit monumental (i projektuar nga Gherardo Bosio, i cili përfundoi ndërtimin në 1941 dhe u shkatërrua në vitin 2016).

“Faji” i ndërtesës është të qenurit e saj në zemrën e qytetit, disa hapa larg nga sheshi Skënderbej, në një pozicion të privilegjuar, tepër të lakmuar të Tiranës, kryeqytetit që po përpiqet të projektojë veten e tij në epokën moderne dhe po e bën këtë duke shkatërruar historinë e tij.

Qeveria, me vendimin nr.377, të datës 08/05/2020, botuar në Fletoren Zyrtare, vendosi t’ia transferojë pronësinë e tokës së Teatrit Kombëtar, një sipërfaqe prej 5 522. m<sup>2</sup>, Bashkisë së Tiranës. Vendimi pohon se ky hap është bërë me qëllim ndërtimin e një ndërtese bashkëkohore dhe sipas standardeve në vend të Teatrit Kombëtar ekzistues.

Është sikur për të ndërtuar një teatër më të madh, të mbuluar e të rehatshëm, të vendoset shembja e Arenës së Veronës ose Koloseumit. Një popull pa histori është një popull pa të ardhme.



**CONFINDUSTRIA ALBANIA**  
Associazione degli Industriali Italiani in Albania

Një Teatër i ri Kombëtar mund të ishte ndërtuar në një zonë tjetër pa shkatërruar një simbol të artit, historisë dhe kulturës.

Teatri Kombëtar ishte një shembull i jashtëzakonshëm i arkitekturës italiane, ishte një dëshmi arkitekturore e lidhjes së thellë të vëllazërimit që ka bashkuar gjithmonë të dy popujt, atë italian dhe atë shqiptar.

Nëse Teatri Kombëtar përfaqësonte të gjitha këto, do të vazhdojë ta bëjë këtë nëpër faqet e gazetave. Ai do të dëshmojë një histori më shumë: atë të dështimit të një politike të padenjë për popullin e vet, që ka zbatuar një strategji të verbër që synon të fshijë fytyrën e qyteteve të tij.

Teatri Kombëtar do të ketë patur edhe 'fajin' e të mos qenurit në përputhje me standardet evropiane (pasi ishte ndërtuar në vitin 1938), por i tillë është edhe ekipi qeveritar, që ndërsa rrëzonte një teatër dhe çonte në polici artistë dhe dhjetëra qytetarëtë armatosur me idetë e tyre, kishin dalë në rrugë duke u përpjekur për të ndaluar barbarinë, dëshmuan se ishin të denjë për Evropën.